

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6851
E premte, 17 mars 2023
çmimi 0.40

Rohde: Me një rezultat ideal në dialog, mosnjohësit do ta njohin Kosovën | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ESCOBARI:

PRES QË KOSOVA DHE SERBIA TË ARRIJNË MARRËVESHJE PËRFUNDIMTARE KËTË VIT.

FAQE 4-5

AKTUALE



SHBA-ja PARALAJMËRON "LUFTIME TË ASHPRA", RUSIA VAZHDON SULMET NË BAHMUT | F. 2

SHQIPËRI: ARRESTOHEN 11 PERSONA PËR ABUZIM ME TENDERIN TREMILIONËSH | F. 3

RRITET NUMRI I UDHËTARËVE ME AEROPLAN | F. 7

EKONOMI



MINISTRI PEÇI KËRKON FUNKSIONALIZIMIN E LIGJIT PËR KONTROLLIN E DUHANIT | F. 8

A PO VJEN NJË KRIZË E RE FINANCIARE NË BOTË? | F. 8

SPORT



SOKOLI: RRAHMANI KËRKOI TË LUANTE TE DRENICA | F. 10



I dërguari special i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka thënë se do të dëshironte që marrëveshja përfundimtare për normalizimin e

raporteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë të arrihej këtë vit. Escobari ka theksuar se Asociacioni është një marrëveshje ekzistuese dhe një detyrim ndërkombëtar që duhet të zbatohet "pavarësisht a do të ketë

një marrëveshje të re apo jo". Përfitimet nga marrëveshja e përgjithshme, tha Escobari, janë integrimi më i shpejtë ekonomik jo vetëm i Kosovës dhe i Serbisë, por i gjithë rajonit f

PUNËTORËT E KEK-ut NË PROTESTË: NËSE S'NA RRIEN PAGAT DO TA LËMË KOSOVËN NË TERR | FAQE 7



MBAHET SESIONI I PARË I TAKIMIT TË DHJETË TË KOMISIONIT PARLAMENTAR TË STABILIZIM-ASOCIIMIT BE - KOSOVË | FAQE 3



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
E-mail: renova@mt.net.mk
Fax: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

ShBA-ja paralajmëron “luftime të ashpra”, Rusia vazhdon sulmet në Bahmut

WASHINGTON, 16 MARS - Më 16 mars ushtria ukrainase raportoi se trupat ruse kishin kryer sulme të shumta në pozicionet ukrainase në dhe rreth qytetit të Bahmutit brenda 24 orëve të fundit, duke vazhduar luftimin intensiv disamujor për kontrollin e qytetit në rajonin lindor të Donjeckut. Sipas njoftimit të përditshëm të lëshuar nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Ukrainës, trupat ukrainase zmbarsën me sukses "sulme të shumta" në zonat veriore dhe perëndimore të Bahmutit, veçanërisht në Orikovo-Vasilivka dhe Bodanivka. Forcat ruse vazhdojnë të përparojnë drejt qendrës së qytetit, duke prerë linjat e furnizimit me energji elektrike, në përpjekje për ta rrethuar qytetin. "Rusia vazhdon të kryejë sulme pavarësisht prej humbjeve", thuhet në raport, ku shtohet se në të njëjtën kohë forcat e Moskës kanë përparuar në zona të tjera kyçe në rajonin e Donjeckut, me fokus në Liman, Avdivka, Marinka dhe Shaktarsk, me më shumë se 75 sulme në 24

orët e fundit.

Rusia, gjithashtu, kreu një sulm me raketa në qytetin lindor të Harkivit, ku kishte cak shkatërrimin e infrastrukturës energjetike dhe civile, tha ushtria. Ndërkohë, zëdhënësi i Pentagonit, gjenerali Pat Ryder, paralajmëroi se muajt në vijim do të jenë vendimtarë për rezultatin e betejës për Ukrainën lindore. "Mendoj se është gjithashtu e rëndësishme të bëjmë një hap prapa dhe ta shikojmë progresin që është arritur, duke pranuar faktin që përpara pret një luftë e vështirë, veçanërisht teksa kalojmë në pranverë dhe verë", ka theksuar Ryder në një konferencë në Pentagon, duke shtuar se Shtetet e Bashkuara do të vazhdojnë të bëjnë gjithçka që është e mundur për t'i përmbushur nevojat ushtarake të Ukrainës.

Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Lloyd Austin, tha në një takim virtual të të ashtuquajturit grupi Ramstein i dhjetëra vendeve që kanë ofruar armë për Kievin, se gjithsej nëntë vende janë zotuar ta furnizojnë Ukrainën me 150



tanke Leopard.

Austin tha se mbrojtja e Ukrainës ka arritur "momentin e saj vendimtar", pasi Rusisë tani "po i mbarojnë opsionet". "Rusisë i është dashur të mbështetet në Iranin dhe Korenë e Veriut dhe të përdorë pajisje të Luftës së Dytë

Botërore. Kështu që Rusisë po i mbarojnë mundësitë dhe miqtë", ka thënë Austin.

Gjenerali amerikan Mark Milley, kryetar i Shefave të Përbashkët të Shtabit, tha pas takimit të grupit Ramstein se Rusia po bën përparime të vogla taktike pranë

Bahmutit, por "me kosto të madhe".

Milley ka deklaruar se liderët ushtarakë të Rusisë nuk po i mbështetin efektivisht trupat e tyre dhe ai nënvizoi se rezervat ushtarake të tyre po shterohen me një ritëm të shpejtë.

Greva mbarëkombëtare kundër planit të Macronit për moshën e pensionit

PARIS, 16 MARS - Mijëra njerëz në Francë iu bashkuan një greve mbarëkombëtare të mërkurën, në përgjigje të planit të presidentit Emmanuel Macron për ta rritur moshën e daljes në pension nga 62 në 64 vjeç. Ndryshimi i propozuar kërkon që punëtorët të paguajnë më shumë në sistem dhe u mohon një pension të plotë atyre që pensionohen në moshën 64-vjeçare pa punuar për 43 vjet. Plani është promovuar si qendror për vizionin e Macronit për ta bërë ekonominë franceze më konkurruese, por sindikatat e kanë kundërshtuar dhe e kanë quajtur shtyrjen e moshës për pensionim



si "mohim i demokracisë".

Greva vjen në mes të trazirave të përhapura në të gjithë Evropën

Perëndimore, duke përfshirë një grevë të mësuesve në Britani dhe një marrëveshje të udhëhequr nga

sindikatat e punëtorëve për t'i rritur kostot e sigurimeve shoqërore për ata që fitojnë më shumë në Spanjë.

Greva në Francë ka shkaktuar ndërprerje në transportin publik dhe ndërprerje në grumbullimin e plehrave, kurse protestuesit janë përplasur me policinë në disa qytete.

Komisioni i ligjvënësve përgjegjës për avancimin e propozimit ka rënë dakord për tekstin përfundimtar dhe shumica konservatore e Senatit pritet ta miratojë atë që të enjten.

Megjithatë, situata në Asambleenë Kombëtare është më e ndërlikuar, pasi aleanca e Macronit humbi

shumicën në zgjedhjet legislative vitin e kaluar, duke e detyruar qeverinë të llogarisë në votat e konservatorëve për ta miratuar projektligjin.

Të majtët dhe ligjvënësit e ekstremitë të djathtë kundërshtojnë ashpër ndryshimin dhe konservatorët janë të ndarë, duke e bërë rezultatin të paparashikueshëm. Megjithatë, Macron mund ta përdorë fuqinë e tij të veçantë kushtetuese për ta kaluar projektligjin në parlament pa votim, por ai mund të përballet me sfida ligjore. Pavarësisht prej protestave, një sondazh tregon kundërshtim të gjerë ndaj projektligjit të pensioneve.

Polonia shkatërron një rrjet rus të spiunazhit

VARSHAVË, 16 MARS - Polonia ka shkatërruar një rrjet spiunazhi që vepronte në vend, konfirmoi ministri i Mbrojtjes të enjten, pasi transmetuesi privat RMF FM raportoi se një grup spiunësh që punonin për Rusinë ishin arrestuar. RMF raportoi të mërkurën se shërbimet polake të sigurisë kishin arrestuar gjashtë persona të dyshuar për spiunazh për Rusinë. Sipas transmetuesit, grupi kishte planifikuar aktivitete sabotuese. "Dua të theksoj suksesin e madh të arritur nga oficerët e Agjencisë së Sigurisë së

Brendshme, sepse i gjithë rrjeti i spiunazhit është çmontuar", tha ministri Mariusz Blaszczak. "Kjo është dëshmi se shërbimet polake punojnë për sigurinë e vendit tonë në një mënyrë shumë efektive", shtoi ai.

Blaszczak nuk pranoi të komentojë më tej mbi rastin dhe tha se më shumë detaje do të jepen nga ministri i Brendshëm Mariusz Kaminski në një konferencë për media.

Të mërkurën presidenti polak Andrzej Duda u takua me drejtorin e CIA-s, William Burns. Zyra e presidentit tha në "Twitter"

se ata diskutuan për "situatën aktuale të sigurisë". Sipas raportit të RMF, gjashtë personat e arrestuar ishin nga qytete në lindje të Polonisë dhe punonin për inteligjencën ruse.

Spiunët kishin vendosur kamera të fshehura në rrugë të rëndësishme hekurudhore, kryesisht në një rajon jugor të vendit.

Sipas RMF, kamerat u gjetën pranë aeroportit Jasionka afër Rzeszov, i cili është bërë një pikë kyçe e transferimit të armëve dhe municioneve që dërgohen në Ukrainë.



Mbahet sesioni i parë i takimit të dhjetë të Komisionit Parlamentar të Stabilizim-Asociimit BE - Kosovë

PRISHTINË, 16 MARS - Më 15 dhe 16 mars ka filluar punimet sesioni i parë i takimit të dhjetë të Komisionit Parlamentar për Stabilizim-Asociim BE - Kosovë në selinë e Parlamentit Evropian në Strasburg të Francës.

Në këtë takim të udhëhequr nga bashkëkryesuesit e këtij Komisioni, Romeo Franz dhe Mimoza Kusari-Lila, nga Kuvendi i Kosovës morën pjesë edhe anëtarët e këtij delegacioni, zëvendëskryesuesi i këtij Komisioni, deputeti Elmi Reçica, deputetët Armend Muja, Fitore Pacolli-Dalipi, Jeta Statovci, Ariana Musliu-Shoshi, Floretë Zejnullahu, Rrezarta Krasniqi, Pal Lekaj dhe Bahrim Sabani.

I ftuar në këtë takim, në emër të Qeverisë së Kosovës ishte

kryeministri Albin Kurti, ambasadori i Kosovës në Bruksel, Agron Bajrami, si dhe ambasadori i Kosovës në Konsullatën e Kosovës në Strasburg, Lulzim Hiseni.

Në fjalën e saj hyrëse, bashkëkryesuesja Kusari-Lila ka theksuar se është e rëndësishme që ky Komision ta vazhdojë ritmin pozitiv të mbajtjes së takimeve dy herë në vit, duke potencuar se është legjislatura e parë që ka pasur këtë dinamikë e që ka rezultuar me miratimin e deklaratave me rekomandime të përbashkëta.

Sesioni i parë i këtij takimi filloi me shkëmbim pikëpamjesh mbi gjendjen e marrëdhënieve BE - Kosovë, ku në emër të Qeverisë së



Kosovës diskutoi kryeministri Albin Kurti, pasuar nga fjalimet e shefit të Njësisë për Bosnjë-Hercegovinë dhe Kosovë në Komisionin Evropian, Vassilis Maragos, këshilltarit të lartë për Ballkanin Perëndimor të

Shërbimit Evropian për Veprim të Jashtëm, Clive Rumbold dhe raportueses së përhershme të Parlamentit Evropian për Kosovë, Viola Von Cramon-Taubadel. Në pjesën e dytë të këtij takimi u diskutua për aplikimin e Kosovës

për anëtarësim në Bashkimin Evropian si dhe përparimin në reformat e integritit në BE.

Për këtë temë Komisionit iu adresuan eurodeputeti Lukas Mandl, deputetja Fitore Pacolli-Dalipi, deputetja Floretë Zejnullahu dhe eurodeputeti Thomas Waitz.


Pjesa e tretë dhe e katërt e këtij takimi si fokus pati temën e dialogut në mes të Prishtinës dhe Beogradit, të drejtat fundamentale dhe pozitën e minoriteteve dhe grave, ku deputetët Mimoza Kusari-Lila, Rrezarta Krasniqi, Bahrim Sabani, Jeta Statovci dhe Ariana Musliu-Shoshi shkëmbyen pikëpamjet e tyre lidhur me këto çështje. Gjatë sesionit në diskutime morën pjesë edhe deputetët Armend Muja dhe Pal Lekaj.

Prokurori i Shtetit dhe Zyra Kombëtare e Auditimit nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi

PRISHTINË, 16 MARS - Më 15 dhe 16 mars ka filluar punimet sesioni i parë i takimit të dhjetë të Komisionit Parlamentar për Stabilizim-Asociim BE - Kosovë në selinë e Parlamentit Evropian në Strasburg të Francës.

Në këtë takim të udhëhequr nga bashkëkryesuesit e këtij Komisioni, Romeo Franz dhe Mimoza Kusari-Lila, nga Kuvendi i Kosovës morën pjesë edhe anëtarët e këtij delegacioni, zëvendëskryesuesi i këtij Komisioni, deputeti Elmi Reçica, deputetët Armend Muja, Fitore Pacolli-Dalipi, Jeta Statovci, Ariana Musliu-Shoshi, Floretë Zejnullahu, Rrezarta Krasniqi, Pal Lekaj dhe Bahrim Sabani.

I ftuar në këtë takim, në emër të Qeverisë së Kosovës ishte



kryeministri Albin Kurti, ambasadori i Kosovës në Bruksel, Agron Bajrami, si dhe ambasadori i Kosovës në Konsullatën e Kosovës në Strasburg, Lulzim Hiseni.

Në fjalën e saj hyrëse,

bashkëkryesuesja Kusari-Lila ka theksuar se është e rëndësishme që ky Komision ta vazhdojë ritmin pozitiv të mbajtjes së takimeve dy herë në vit, duke potencuar se është legjislatura e parë që ka pasur këtë

dinamikë e që ka rezultuar me miratimin e deklaratave me rekomandime të përbashkëta.

Sesioni i parë i këtij takimi filloi me shkëmbim pikëpamjesh mbi gjendjen e marrëdhënieve BE - Kosovë, ku në emër të Qeverisë së Kosovës diskutoi kryeministri Albin Kurti, pasuar nga fjalimet e shefit të Njësisë për Bosnjë-Hercegovinë dhe Kosovë në Komisionin Evropian, Vassilis Maragos, këshilltarit të lartë për Ballkanin Perëndimor të Shërbimit Evropian për Veprim të Jashtëm, Clive Rumbold dhe raportueses së përhershme të Parlamentit Evropian për Kosovë, Viola Von Cramon-Taubadel.

Në pjesën e dytë të këtij takimi u diskutua për aplikimin e Kosovës

për anëtarësim në Bashkimin Evropian si dhe përparimin në reformat e integritit në BE.

Për këtë temë Komisionit iu adresuan eurodeputeti Lukas Mandl, deputetja Fitore Pacolli-Dalipi, deputetja Floretë Zejnullahu dhe eurodeputeti Thomas Waitz.

Pjesa e tretë dhe e katërt e këtij takimi si fokus pati temën e dialogut në mes të Prishtinës dhe Beogradit, të drejtat fundamentale dhe pozitën e minoriteteve dhe grave, ku deputetët Mimoza Kusari-Lila, Rrezarta Krasniqi, Bahrim Sabani, Jeta Statovci dhe Ariana Musliu-Shoshi shkëmbyen pikëpamjet e tyre lidhur me këto çështje. Gjatë sesionit në diskutime morën pjesë edhe deputetët Armend Muja dhe Pal Lekaj.

Shqipëri: Arrestohen 11 persona për abuzim me tenderin tremilionësh

Tiranë, 16 mars - Kryetari i bashkisë së Bulqizës në Shqipëri është arrestuar me urdhër të Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK).


Kryebashkiaku Lefter Alla akuzohet për "shpërdorim detyrë" dhe "shkelje të barazisë në tenderë".

Bashkë me të është arrestuar edhe nënkryetarja e bashkisë së Bulqizës, Enkeleda Lleshi, si dhe 9 persona të tjerë, ndërsa dy të tjerë janë në "arrest shtëpie".

Sipas SPAK, Alla akuzohet se ka

favorizuar kompaninë e një mikut të tij në tenderin për ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit të qytetit të Bulqizës. Tenderi kapte vlerën 322 milionë lekë ose 3 milionë euro.

SPAK thekson se "Lefter Alla në bashkëpunim me nënkryetaren e Bashkisë dhe punonjësit e tjerë, si specialistë të prokurimeve, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, kanë bërë të mundur krijimin e avantazheve për kompaninë fituese. Ndërsa punimet janë kryer nga një kompani tjetër, që rezultoi të



ketë lidhje shoqërore me kryetarin e bashkisë". Sipas SPAK, procedura e ndjekur

bie në kundërshtim me Ligjin për Prokurimet Publike, ndërsa bashkia Bulqizës miratoi disa

vendime duke ngritur një mekanizëm të posaçëm për ta favorizuar firmën fituese.

Pas arrestimit të zyrtarëve të bashkisë së Bulqizës, policia gjyqësore ka ushtruar kontrolle në zyrat e bashkisë së Bulqizës si dhe të kompanive që kanë fituar tenderin për ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit në këtë qytet.

Kontrolle janë kryer edhe në banesat e të arrestuarve.

Arrestimi i Allës vjen dy muaj para zhvillimit të zgjedhjeve lokale që do të mbahen në Shqipëri më 14 maj.

Nga 16 marsi s'ka më vetura pa stikersa

PRISHTINË, 16 MARS - Nga e enjta asnjë automjetet nëpër rrugët e Kosovës nuk duhet të jetë pa ngjitës (stikers) i cili dëshmon se automjeti në fjalë ka të kryer procesin e regjistrimit ashtu siç parashihet me ligjet në fuqi. Gjatë vitit të parë të zbatimit të

projektit për vendosjen e ngjitësve, i mbështetur financiarisht 100 për qind nga kompanitë e sigurimeve që operojnë në vendin tonë, rezultatet janë të dukshme.

Drejtori i Byrosë Kosovare të Sigurimit, Sami Mazreku, ka

vlerësuar se projekti në fjalë ka dhënë rezultate të mëdha vitin e parë, por rezultate edhe më të mëdha do të jepen sivjet. "Vitin e parë ngjitësi ka pasur ngjyrë të kuqe, këtë vit ka ngjyrë të gjelbër dhe praktikisht sot bëhet një vit, kështu që nga 16

marsi asnjë automjetet nëpër rrugët e Kosovës nuk duhet të jetë pa ngjitës", ka thënë Mazreku.

Sipas tij, përmes këtij projekti pritet edhe më shumë ulja e numrit të automjeteve të paregjistruara në vendin tonë.





Escobari: Pres që Kosova dhe Serbia të arrijnë marrëveshje përfundimtare këtë vit

I dërguari special i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka thënë se do të dëshironte që marrëveshja përfundimtare për normalizimin e raporteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë të arrihej këtë vit. Escobari ka theksuar se Asociacioni është një marrëveshje ekzistuese dhe një detyrim ndërkombëtar që duhet të zbatohet “pavarësisht a do të ketë një marrëveshje të re apo jo”. Përfitimet nga marrëveshja e përgjithshme, tha Escobari, janë integrimi më i shpejtë ekonomik jo vetëm i Kosovës dhe i Serbisë, por i gjithë rajonit

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 16 MARS - I dërguari special i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka thënë se do të dëshironte që marrëveshja përfundimtare për normalizimin e raporteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë të arrihej këtë vit. “Mendoj se një gjë e tillë është plotësisht e mundur”, ka thënë Escobari gjatë konferencës për medie në Beograd.

Ai ka thënë se kjo marrëveshje nuk është diçka për t'u frikësuar. “Shpresojmë se nuk do të ndryshojë rrënjësisht jetën e askujt, por se do të mundësojë një nivel të caktuar stabiliteti dhe paqeje për njerëzit në rajon. Synimi i saj nuk është të krijojë pengesa të reja. E kundërta. Ne dëshirojmë që kjo marrëveshje të jetë e mirë jo vetëm për Serbinë dhe Kosovën, por sepse Serbia dhe Kosova janë në zemër të Ballkanit Perëndimor, për të krijuar mundësi edhe për fqinjët tuaj”, ka thënë Escobar.

Escobari foli në Beograd dy ditë para raundit të ri të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, që pritet të mbahet më 18 mars në Ohër të Maqedonisë së Veriut, në të cilën palët do të bisedojnë për zbatimin e propozimit evropian. I pyetur nëse pas vizitës së tij dhe të Lajçakut në Serbi mund të thuhet se formimi i Asociacionit është më afër sesa ishte një muaj më parë, ai konfirmoi pozitivisht. “Mund të them se bisedimet tona me Qeverinë e Kosovës po bëhen gjithnjë më produktive dhe realiste. Shpresoj se ne jemi shumë më afër kësaj sesa disa javë më parë”, ka deklaruar Escobari. Escobari, po ashtu, tha se Asociacioni është një marrëveshje ekzistuese dhe një detyrim ndërkombëtar që duhet të zbatohet, “pavarësisht a do të ketë një marrëveshje të re apo jo”. Gjatë konferencës në Beograd, Escobari u bëri thirrje palëve nga Kosova dhe Serbia të jenë konstruktive dhe fleksibile gjatë takimit në Ohër. “Propozimi evropian për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është një nga

mundësitë më të mira për ta çuar rajonin përpara dhe për të krijuar kushte paqësore për të gjithë njerëzit që jetojnë në rajon”, ka theksuar i dërguari special i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor. “Pritjet tona janë që të dy liderët të jenë në gjendje ta dëgjojnë njëri-tjetrin dhe që ata do të punojnë për ta bërë këtë marrëveshje realitet. Të mendojnë për pengesat, të kërkojnë mënyra për t'i kapërcyer ato dhe të largohen nga takimi duke kuptuar se do të vazhdojnë të punojnë deri në zgjidhje”, ka thënë ai.

I dërguari special i ShBA-së tha se nuk pret që gjatë takimit në Ohër të ketë nënshkrime, por theksoi se do të hapet rruga për përparim të mëtejshëm. Megjithatë, ai nuk dëshiroi të flasë se çfarë mund të ndodhë nëse Ohri nuk jep rezultate. Escobari rikujtoi se kjo është një marrëveshje për normalizim, jo për njohje, por ai përsëriti qëndrimin e ShBA-së se Kosova është shtet i pavarur me integritet territorial dhe sovranitet. Dokumenti prej 11 nenesh që është bërë publik nga Bashkimi Evropian nuk përmend në

mënyrë specifike njohjen e ndërsjellë që Qeveria e Kosovës ka thënë se duhet të jetë në qendër të një marrëveshje eventuale për normalizim të raporteve. Megjithatë, në nenin 2 të propozimit përmendet që palët duhet të respektojnë pavarësinë, sovranitetin dhe integritetin territorial të njëra-tjetrës. Propozimi, po ashtu, përfshin zotimin e palëve për t'i respektuar të gjitha marrëveshjet e arritura deri më tani në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve si dhe përkushtimin e tyre për të mos e penguar njëra-tjetrën në proceset integruese. Përfitimet nga kjo marrëveshje, tha Escobari, janë integrimi më i shpejtë ekonomik jo vetëm i Kosovës dhe i Serbisë, por i gjithë rajonit. “Ajo që është ndryshe tani krahasuar me dy vjet më parë është se tani shihni një bisedë reale brenda dy shteteve, Kosovës dhe Serbisë, se çfarë do të thotë për Serbinë dhe Kosovën të kenë marrëdhënie paqësore, të parashikueshme dhe konstruktive. Të gjithë në rajon do të përfitonin nga kjo. Është diçka që është reale, nuk është bisedë e

Rohde: Me një rezultat ideal në dialog, mosnjohësit do ta njohin Kosovën

Prishtinë, 16 mars - Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde, thotë se është "i sigurt" se Kosovën do ta njohin shtetet mosnjohëse të Bashkimit Evropian nëse ka rezultate në normalizimin e marrëdhënieve të saj me Serbinë. Në një intervistë dhënë "Radios Evropa e Lirë", ai inkurajon

udhëheqësin e Kosovës dhe atë të Serbisë, Albin Kurtin dhe Aleksandër Vuçiqin, që ta shfrytëzojnë takimin e 18 marsit në Ohër për të arritur marrëveshje për zbatimin e planit të BE-së për normalizimin e marrëdhënieve. Në mungesë të konstruktivitetit nga palët, Rohde përmend

mundësinë e sanksioneve nga BE-ja. Rohde, po ashtu, thotë se dy vendeve u janë premtuar edhe investime shtesë si shpërblim për konstruktivitet në dialog. Ai thotë se Kosova duhet ta përmbushë obligimin gati 10-vjeçar për themelimin e Asociacionit të

Komunave me Shumicë Serbe. "Duke e themeluar Asociacionin ne shpresojmë se do t'i integrojmë serbët e Kosovës brenda shtetit". Ai, po ashtu, tha se pa njohje nuk e sheh ndonjërin vend në BE. "Është diskutuar edhe më herët se ka disa vende që nuk e njohin (Kosovën) brenda Bashkimit Evropian. Kam

shumë shpresë dhe në vazhdimësi jemi në kontakt me ta. Kam shumë shpresë që një rezultat pozitiv më 18 mars do t'i zhbllokojë edhe mosnjohjet. Nuk ka garanci, por nuk shoh ndonjë arsye për mosnjohje kur vetë dy shtetet [Serbia dhe Kosova] kanë njohje de facto mes vete", ka thënë Rohde.



rrëshme, sepse po flasim për mundësi reale", ka deklaruar Escobari.

Mundësia që të dyja palët t'i shohin përfitimet e kësaj marrëveshjeje është shumë e madhe, tha Escobari dhe shtoi se "kjo është ajo që më së shumti u nevojitet serbëve në Kosovë". "Ata janë gjithmonë në qendër të konfrontimeve, tensioneve dhe kjo u shkakton atyre dëme psikologjike dhe dëme të tjera", theksoi ai.

Sipas Escobarit, pozita e serbëve në Kosovë do të përmirësohet përmes zbatimit të marrëveshjes për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Escobari tha se pret nga Kosova që një nga modelet e propozuara të përfaqësuesit special të BE-së, Miroslav Lajçak, të jetë model për Asociacionin. "Kur flas për këtë si kërkesë, nuk dua të shkaktoj një konfrontim apo ta paraqes atë si një sfidë. Fakti është se Asociacioni është pjesë e marrëveshjes së Brukselit... do të realizohet. Pyetja e vetme është sa shpejt do të ndodhë. Pjesa e dytë, cili model do të zbatohet. Përfaqësuesi i posaçëm i BE-së përmendi disa shembuj të ndryshëm se si funksionon ky lloj Asociacioni në BE, për t'u dhënë pakicave të drejtën e vetëqeverisjes, e cila

nuk ndikon në funksionalitetin, nuk nxit tensione dhe ndihmon në afrimin e vendeve. Ne dëshirojmë që njëri prej atyre modeleve të jetë model për komunitetin e komunave me shumicë serbe", u shpreh Escobar.

Ai, po ashtu, bëri me dije se në Ohër do të diskutohet edhe për pjesëmarrjen e serbëve në veri në zgjedhjet e jashtëzakonshme, më 23 prill, si dhe për kthimin e tyre në institucionet e Kosovës. "Unë do të doja të shihja se çfarë mund të bëjmë në Ohër për ta arritur këtë", ka thënë ai.

Escobari gjatë së mërkurës është takuar me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Në takim, siç thuhet në komunikatën e Presidencës së Serbisë, është diskutuar për procesin e normalizimit të marrëdhënieve me Kosovën, formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe dhe për "mundësitë për gjetjen e zgjidhjeve kompromisi dhe të qëndrueshme në dialogun e zhvilluar me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian".

Escobari do të qëndrojë të enjten dhe te premten në Kosovë. Ai pritet të takohet me presidenten Vjosa Osmani dhe kryeministrin Albin Kurti.

Borrelli: Është koha që Kosova dhe Serbia të marrin përgjegjësi

Shefi i politikës së jashtme i Bashkimit Evropian, Josep Borrell, tha se është koha që Kosova dhe Serbia të marrin përgjegjësi dhe të lëvizin drejt BE-së. BE-ja është "shtëpia e fundit" për dy vendet, tha ai. Borrelli i bëri komentet në një blog autorial, të publikuar në prag të takimit të radhës midis kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, më 18 mars në Ohër të Maqedonisë së Veriut.

Në një takim në Bruksel, më 27 shkurt, ata e pranuan në parim përmbajtjen e këtij plani që njihet edhe si marrëveshje drejt normalizimit. "Tani është koha që Serbia dhe Kosova të bien dakord për aneksin e zbatimit, i cili është pjesë integrale e marrëveshjes dhe të kenë mirëkuptim të qartë për mënyrat e zbatimit të dispozitave të saj", ka shkruar Borrelli.



Ai ka theksuar se do të vazhdojë të punojë për arritjen e një "marrëveshjeje gjithëpërfshirëse për normalizimin e marrëdhënieve", që "është e pranueshme për vendet anëtare të BE-së" e që është "në përputhje me të drejtën ndërkombëtare" dhe "i kontribuon stabilitetit rajonal". "Marrëveshja në tryezë është një hap i rëndësishëm drejt këtij

objektivi", ka deklaruar Borrelli.

Borrelli i inkurajoi ata që të angazhohen për zbatimin e saj, duke thënë se një gjë e tillë do t'i japë fund përballjes me kriza dhe "do ta zhvendosë vëmendjen te normalizimi dhe pajtimi".

Dialogu, tha Borrelli, nuk ka të bëjë vetëm me Kosovën dhe Serbinë. "Ai duhet parë në kontekstin aktual më të gjerë gjeopolitik - një moment përcaktues në historinë evropiane", ka theksuar Borrelli, duke shtuar se lufta e Ruisë në Ukrainë "e ka ndryshuar pamjen". "Shumica e njerëzve që jetojnë në Ballkan duan të shikojnë përpara dhe jo prapa... Ata, sigurisht, nuk janë një çip, për t'u përdorur nga [presidenti rus, Vladimir] Putin në ëndrrat e tij imperialiste. Ballkani Perëndimor është pjesë e Evropës", tha kryediplomati i BE-së.

Nxënësit e shkollës "Zenel Hajdini" në Tërstenik trajnohen për sigurinë në rrugë

DRENAS, 16 MARS - Policia e Kosovës, në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Arsimit në Drenas, përkatësisht me psikologun e kësaj drejtorie, Hazir Elshani, kanë vazhduar ligjëratat me nxënës të shkollave fillore për t'i vetëdijësuar për rrezikun në

komunikacion. Në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët "Zenel Hajdini" në Tërstenik, me nxënës të klasave 7, 8 dhe 9 është mbajtur ligjëratat me karakter vetëdijësues. Temë e ligjëratës ka qenë siguria rrugore si një e drejtë dhe përgjegjësi për të

gjithë. Ligjëratën e kanë mbajtur policia e Drenasit së bashku me psikologun e Drejtorisë Komunale të Arsimit, Hazir Elshani. Ligjëratat me karakter vetëdijësues për sigurinë rrugore do të vazhdojnë të mbahen në shkollat e tjera.



Nagavci vazhdon aktivitetet në kuadër të fushatës sensibilizuese kundër dhunës në shkolla

Prishtinë, 16 mars - Në kuadër të fushatës një mujore sensibilizuese kundër dhunës në shkolla me moton "Të gjithë së bashku për shkollën miqësore", ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, ka qëndruar në qytetin e Gjakovës, ku është takuar me koordinatorët e cilësisë në shkollat e kësaj komune. Në këtë takim është biseduar për karakterin e fushatës dhe zbatimin e politikave kundër dhunës në shkolla.

Ministrja Nagavci ka theksuar se, sado që të kemi politika të mira, faktori më i rëndësishëm në këtë drejtim vazhdojnë të mbesin mësimdhënësit dhe ata që punojnë drejtpërdrejt me fëmijët. Po ashtu, ministrja ka theksuar nevojën e angazhimit të të gjithë aktorëve në mënyrë që të avancohet çështja e sigurisë të fëmijëve. Ajo ka thënë se do ta kenë përkrahjen e saj dhe të

MASHTI-t për ta zgjidhur çdo vështirësi në këtë drejtim.

Më pas, ministrja Nagavci është takuar me një grup të nxënësve në shkollën "Kelmend Rizvanolli" në Gjakovë, me të cilët ka biseduar për pasojat që sjell çdo mënyrë e dhunës në zhvillimin e fëmijëve. Pasi që u është përgjigjur shumë pyetjeve të nxënësve, ministrja i ka porositur ta adresojnë dhunën kudo që ata e identifikojnë. Në këto takime u theksua roli i rëndësishëm që ka psikologu dhe pedagogu në shkolla.

Ministrja Nagavci bëri me dije se Qeveria e Kosovës tashmë ka ndarë buxhetin për rritjen e numrit të psikologëve në shkolla dhe uroi që komunat në kuadër të përgjegjësisë që kanë, këtë çështje ta trajtojnë me seriozitet, të shpallin konkurset dhe të mos pranojnë kuadër tjetër për pozitat të cilat i kanë të lejuara për psikologë.



Java e Kulturës e Kosovës në Portugali



PRISHTINË, 16 MARS - Për t'i thelluar njohuritë e ardashësve të huaj për identitetin kulturor të Kosovës, një sërë formash arti vendase do të shfaqen në kuadër të Javës së Kulturës së Kosovës në Portugali, nga 19 deri më 24 mars. Kjo javë është krijuar për ta festuar identitetin e pasur kulturor dhe format e ndryshme të artit të Kosovës.

Gjatë pesë ditëve një sërë ngjarjesh kulturore do të zhvillohen në Lisbonë, Braga dhe Porto, duke shfaqur një sërë formash arti, si: muzika, teatri, gastronomia dhe filmi. Qëllimi i këtyre ngjarjeve është shfaqja e talentit artistik dhe identitetit kulturor të Kosovës, duke krijuar lidhje mes artistëve nga Kosova, diaspora dhe vendet pritëse.

Java e Kulturës së Kosovës jashtë vendit është një nismë e përbashkët ndërmjet Ministrisë së

Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD) dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS). Ajo është krijuar për ta promovuar identitetin kulturor dhe potencialin artistik të Kosovës në skenën ndërkombëtare.

Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës ka njoftuar se kjo ngjarje premtan të jetë një përvojë unike, e paharrueshme që nxjerr në pah talentin artistik dhe identitetin kulturor të Kosovës dhe popullit të saj. "Arti mund t'i bashkojë njerëzit, ta nxitë mirëkuptimin, ndjeshmërinë dhe të promovojë paqen dhe bashkëpunimin midis vendeve. Nëpërmjet shkëmbimeve njerëz për njerëz si kjo ngjarje, ne formësojmë dhe promovojmë imazhin e Kosovës jashtë vendit dhe forcojmë lidhjet tona kulturore me partnerët dhe aleatët tanë", ka njoftuar MPJD.

Vazhdojnë aktivitetet e zhvillimit profesional për infermierët e QKMF-së në Mitrovicë

MITROVICË, 16 MARS - Në Qendrën për Zhvillim të Vazhdueshëm Profesional të QKMF-së "Dr. Nexhat Çuni" po vazhdojnë aktivitetet e zhvillimit profesional të infermierëve sipas planit të punës për vitin 2023.

Në kuadër të këtyre aktiviteteve më 13, 14, 15 dhe 16 mars po

mbahen ligjëratat me temën "Procesi i komunikimit, faktorët që ndikojnë në komunikim", ligjëruar nga infermierja Fatmire Beka Qenaj, trajnere në Qendrën Trajnuese.

Me këtë rast, infermierja Beka Qenaj ka bashkëbiseduar me infermierët për procesin e komunikimit, duke e cilësuar

atë si çelësin kryesor për shërbime të mirëfillta njerëzore, në veçanti për ato profesionale.

Interesimi i infermierëve për pjesëmarrje në këto ligjëratat ishte mjaft i madh, ndërsa në nivel të lartë ishte edhe organizimi nga ana e trajnueses Beka Qenaj.



Rritet numri i udhëtarëve me aeroplan

PRISHTINË, 16 MARS - Është rritur dukshëm numri i udhëtarëve me aeroplan, ndërsa transporti i mallrave me tren ka qenë zero tonelata. Kështu ka njoftuar Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) në raportin "Statistikat e Transportit dhe Telekomunikimit, janar 2023", duke shtuar se numri i udhëtarëve që kanë shfrytëzuar trenin si mjet udhëtimi është rritur mbi 50 për qind. "Numri i futurimeve të realizuara ishte 808 ose 4.53 për qind më shumë se në

periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa numri i udhëtarëve në total ishte 235,567 ose 21.36 për qind më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Ndërsa numri i udhëtarëve që kanë shfrytëzuar trenin si mjet udhëtimi ishte 6 505 ose 55.7 për qind më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kurse sasia e mallrave të transportuara me tren në neto tonelata ishte zero", ka bërë me dije ASK-ja. Sipas ASK-së, numri i përdoruesve të njetit telefonik fiks

ishte 68 194 ose 9.32 për qind më pak se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. "Në telefoninë mobile, në muajin janar 2023, numri i përdoruesve me parapagim (Prepaid) ishte 1 milion e 518 mijë e 712 ose 3.64 për qind më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa numri i përdoruesve me kontratë (Postpaid) ishte 272 mijë e 733 ose 2.22 për qind më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar", është theksuar në raportin e ASK-së.



Mbi 200 kompani vendore dhe të huaja, pjesë e Panairit të Turizmit në Prishtinë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 16 MARS - Për tri ditë me radhë në Prishtinë do të mbahet edicioni i dytë i Panairit Ndërkombëtar të Turizmit, organizuar nga Unioni i Turizmit të Kosovës. Në këtë panair po marrin pjesë më shumë se 200 kompani të turizmit me ofertat e tyre. Sipas organizatorëve, qëllimi kryesor i këtij panairi është promovimi i turizmit dhe traditave kosovare.

Në hapje të këtij edicioni ishte edhe presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e cila e turizmin e konsideroi si industri që hap vende të punës dhe me të ardhura të mira. Osmani ka përmendur edhe festivalet e ndryshme që organizohen në Kosovë që, sipas saj, e kanë ndryshuar imazhin e Kosovës. "Turizmi kontribuon në ngritjen e ekonomike të shtetit. Sot turizmi si industri krijon vende të shumta dhe të ardhura për qytetarët. Turizmi kulturor kontribuon në ruajtjen e traditave dhe kulturës sonë. Ky panair ka mbledhur kompani të ndryshme dhe kjo është tejet fituese jo vetëm për komunat, por edhe për të tjerët. Pozita gjeografike e Kosovë



mundëson pozitën për një turizëm të mirë. Kosova nuk është më pak e bukur se vendet e tjera, në fakt ka bukuri të jashtëzakonshme", ka thënë Osmani.

Kryetari i Unionit të Turizmit të

Kosovës, Baki Hoti, ka dhënë detaje për këtë panair. "Kemi arritur që më në fund edhe Kosova të ketë një panairi të përmasave të tilla me mbi 200 kompani vendore dhe të huaja. Qëllimi kryesor është që të bëhet

promovimi i turizmit, traditave tona dhe i vlerave tona. Mendoj se kemi bërë një punë të mirë", ka thënë ai.

Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka thënë se do ta ketë në fokus ngritjen e

kapaciteteve të turizmit. Organizimi i këtij panairi është mirëpritur edhe nga komunat dhe kompanitë turistike. Sipas tyre, këto organizime ndikojnë shumë në ekonominë e vendit dhe në promovimin e turizmit.

Punëtorët e KEK-ut në protestë: Nëse s'na rritin pagat do ta lëmë Kosovën në terr

EPOKA
ERE

F. DRËMAKU

PRISHTINË, 16 MARS - Me kërkesën për rritje të pagave, punëtorët e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) të enjten kanë mbajtur një protestë në sheshin "Nënë Tereza" në Prishtinë. Krahas rritjes së pagës, punëtorët e KEK-ut kanë kërkuar edhe pagesë më të lartë për shujtë, rrezikshmëri në punë, pagesë për punën në fundjavë sipas Ligjit të Punës si dhe respektimin e vendimeve të gjykatës. Kërkesë tjetër e punëtorëve të

KEK-ut është edhe pagesa për punën në fundjavë për punëtorët me ndërrime. Kryetari i Sindikatës së Re, Nexhat Llumnica, ka deklaruar se kërkesat e tyre janë esenciale. "Më vjen keq shumë se të rinjtë ikin prej vendit tonë për papunësi, kurse KEK-u i ka 2 000 punëtorë mungesë. I lus të gjitha institucionet përkatëse që të hapin konkurse e t'i punësojnë të rinjtë, sepse punëtorët po sfidohen shumë me tri ndërrime. Të punosh 16 orë nuk është njëjtë si të punosh 8 orë. Në vitin 2021 i kemi pasur 35 të vdekur nga

sëmundjet profesionale që dyshojnë se i bartin aty, pra ne jemi të rrezikuar dhe rrezikshmëria nuk paguhet. Ne kemi kërkuar marrëveshje kolektive. Është e vetmja kompani publike që s'ka marrëveshje kolektive", ka thënë Llumnica. Gjithashtu, ai ka treguar se nëse nuk u rriten pagat do ta lënë Kosovën në terr. "Nëse nuk ngrihen pagat do ta lëmë Kosovën në terr", ka theksuar ai.

Në përkrahje të kësaj proteste ka dalë edhe Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK).



Ministri Peci kërkon funksionalizimin e Ligjit për Kontrollin e Duhanit

PRISHTINË, 16 MARS - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Faton Peci, ka kërkuar nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, që duke u bazuar në përgjegjësitë ligjore, si dhe interesimin për funksionalitet të plotë karshi mandatit dhe përgjegjësi që ka AUV, të merren masa rigorozë kundrejt zbatimit të

Ligjit për Kontrollin e Duhanit si dhe shtim të aktivitetit të inspektorëve sanitarë në terren.

Ministri i BPZHR-së, Faton Peci, u shpreh se çdo qytetar i Republikës së Kosovës gëzon të drejtën ligjore që të mbrohet nga ekspozimi ndaj tymit të duhanit. “Nga sot, zero tolerancë ndaj duhanit në

ambiente të mbyllura, hapësira publike, të punës, në hapësira të transportit publik dhe në çdo hapësirë tjetër që përcaktohet me Ligjin nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit”, ka pohuar ministri Peci.

Për mosrespektim të ligjit në fjalë nga personat fizikë dhe subjektet juridike do të pasojnë gjokat të cilat i përcakton ligji.



Sesion informues për anëtarët e Shoqatës së Kontabilistëve dhe Auditorëve

PRISHTINË, 16 MARS - Në kuadër të programit të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional, më 14 dhe 15 mars është mbajtur sesioni i radhës informues në bashkëpunim me Shoqatën e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Certifikuar të Kosovës, me temat: Rimbursimet Tatimore dhe Deklarimi Tremujor dhe Vjetor për: Tatim në të Ardhura Personale (IS, IL, PD dhe DI); Tatim në të Ardhura të Korporatave (QS, QL dhe CD); Ortakëritë (DO); Individët (DI). Përmes këtij sesioni, anëtarët e ShKÇAK janë njoftuar lidhur me kërkesat për rimbursim të: Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), Tatimit në të Ardhura Personale (TAP) dhe Tatimit në të Ardhura të Korporatave (TAK). Gjithashtu, përmes këtij sesioni anëtarët e ShKÇAK janë njoftuar lidhur me Deklarimin dhe Pagesën e Tatimit në të Ardhura, si për: Bizneset e vogla individuale (IS); Bizneset e mëdha individuale (IL dhe PD); Korporatat e vogla (QS);



Korporatat e mëdha (QL dhe CD); Ortakëria (DO); dhe Individët (DI).

Më konkretisht përmes këtij seminari/EVP janë ofruar sqarime se si dhe kur mund të parashtrihen kërkesat për

rimbursim të TVSh-së, TAP dhe TAK, si dhe disa probleme të identifikuar nga ATK lidhur me shqyrtimin e kërkesave për rimbursim.

Po ashtu, janë ofruar sqarime lidhur me Deklarimin dhe

Pagesën e Tatimit në të Ardhura si nga Individët, Bizneset e vogla Individuale/Korporata, ashtu edhe nga Bizneset e mëdha Individuale/Korporata.

Në këtë seminar/EVP janë paraqitur edhe shembuj dhe

ushtrime për të bërë më të mundur të kuptuarit e drejtë të gjitha temave të lartcekura. Ligjërues i këtij sesioni ishte Sami Salihu, zëvendës drejtor ekzekutiv në Administratën Tatimore të Kosovës.

A po vjen një krizë e re financiare në botë?

BERN, 16 MARS - Rregullatorët zviceranë kanë thënë se janë të gatshëm ta ndihmojnë gjigantin bankar “Credit Suisse” “nëse është e nevojshme”, duke thënë se banka nuk është në rrezik. Deklarata erdhi pasi aksionet në bankë ranë për 24 për qind, i cili është një nivel rekord i ulët. Investitorët janë të shqetësuar se si banka, e rrethuar nga problemet, do t’i trajtojë pasojat nga dështimet e bankave amerikane. Këto shqetësime nxitën shitjen

e shumë aksioneve bankare, raporton BBC.

Banka Kombëtare Zvicerane (SNB) dhe Autoriteti Zviceran i Mbikëqyrjes së Tregut Financiar përmes një deklarate të përbashkët pohuan se rregullat strikte të zbatuara prej institucioneve financiare zvicerane “sigurojnë stabilitetin e tyre”.

“Problemet e disa bankave në ShBA nuk paraqesin rrezik të drejtpërdrejtë për tregjet financiare zvicerane”, thanë rregullatorët. “‘Credit Suisse’ plotëson kërkesat e kapitalit

dhe likuiditetit të vendosura për bankat me rëndësi. Nëse është e nevojshme, SNB do t’i sigurojë [‘Credit Suisse’] likuiditet”, pohuan ata.

Problemet në sektorin amerikan bankar filluan javën e kaluar me falimentimin e “Silicon Valley Bank”, banka e 16 më e madhe në vend. Banka e specializuar në kreditimin e kompanive të teknologjisë u mbyll nga rregullatorët amerikanë javën e kaluar në atë që ishte dështimi më i madh i një banke amerikane që nga viti 2008.



Mbahet ankandi i tretë i letrave me vlerë për vitin 2023, shiten 15 milionë euro me kohëzgjatje prej 7 vjetësh



PRISHTINË, 16 MARS - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka njoftuar se më 23 mars do të mbahet ankandi i tretë për vitin 2023. Në këtë ankand do të emetohen obligacione me maturitet shtatëvjeçar në shumën prej 15 milionë eurosh. “Nga kjo

ministri bëhet e ditur se investimi në obligacione është investim i sigurt, i garantuar me Ligjin për Borxhin Shtetëror dhe Garancitë Shtetërore, ku interesi i përcaktuar nga tregu garantohet për të gjithë kohëzgjatjen (7 vjet) dhe është

tërësisht i liruar nga tatimi”, thuhet në njoftimin e Ministrisë së Financave. Ministria thotë se për detaje rreth pjesëmarrjes në ankande për blerjen e letrave me vlerë duhet të kontaktohet ndonjëra nga bankat komerciale që operojnë në Kosovë.

Epoka e kaosit të opinioneve



Nga Moikom ZEKO

Në fundin e vitit të kaluar, kryeredaktori i Ditës, Adrian Thano, më dërgonte një email, ku më thoshte të shkruaja diçka për vitin që kaloi, dhe si kalimthi, më sugjeronte të shkruaja diçka për Njeriun dhe Antinjeriun.

Ky sugjerim më shtyu të rilevoj një libër të edicionit në frëngjisht të Gallimard-it "La defaite de la pensée" ("Disfata e mendimit") të filozofit të njohur francez Alain Finkelkraut.

Libri në fjalë, i përkthyer në shumë të botës, është një libër kritikist, me një kirurgji mendore të habitshme për mendimin njerëzor në

përgjithësi.

Ideja kryesore e tij lidhet se në qytetërimin aktual: Ne jetojmë Epokën Post-faktuale! Domethënë, kemi të bëjmë me një mjedis universal, ku është kapërcyer statusi i Faktit, ose i fakteve, nuk respektohet patjetërsueshmëria e tyre sepse kemi hyrë në një erë të re, në atë të Opinioneve.

Sot njerëzit operojnë me opinione, përlëshen midis tyre, kacafyten, por realisht nuk u referohen më fakteve që kanë autoritet të padiskutueshëm. Pra, shoqëria moderne si disfatë të parë të mendimit ka këtë kapërcim, që gjithsesi është negativ.

Ky filozof e shikon me shqetësim të

ardhmen e qytetërimin dhe të mendimit të epërm, që po zëvendësohet nga bota virtuale, kur njeriu tashmë konsiderohet si "banor i WWW-së, një qenie e manipuluar e internetit dhe rrjeteve sociale".

Kultura e madhe e shekujve po zëvendësohet nga kultura përherë e më e përhapur e spektakleve, madje dhe politika sot strukturohet si performancë, apo dhe spektakël.

Ky konkluzion i këtij filozofi mund të shpjegojë deri diku optikën edhe të zhvillimeve politike, tejet kontradiktore, me paradokse të pashembullta të debateve në Kuvend, apo dhe në media, që ngjajnë me performanca të

sipërfaqshme dhe dëgjimore të një arti vulgar, populesk, të rrugës.

Paradigma e Njeriut dhe Antinjeriut që më sugjeroi Thano, ka të bëjë me forcat pozitive në luftë të përditshme me forcat negative.

Nuk është një çështje rrethore e klasifikimit. Kemi të bëjmë më tepër me nocionet dialektike të konceptualitetit. Mendimi përparimtar i njerëzimit nuk mund të shkëputet nga humanizmi. Këtu parlamentar nuk mund të zëvendësojë kërkimin për të vërtetën. Utilitarizmi global nuk mund ta fashitë qenien njerëzore, ta mpijë atë dhe t'i mohojë të drejtën për të bërë pyetjen "Pse?".

Sipas Finkelkraut njeriu i kulturës e lufton tiraninë e banalitetit, por "kolonizimi" i institucioneve kryesore nga mediokriteti është akoma më i frikshëm.

Në debatet politike shqiptare përgjithësisht populli e di se ç'është thotë të jesh klon i Antinjeriut.

Ndërsa në anën e Njeriut është tërë fuqia e brendshme shpirtërore e substancës së kombit shqiptar, e intelektualëve që nuk u bënë kurrë klientelistë, që sakrifkuan, madje dhe u marxhinalizuan, por e thanë haptazi mendimin e tyre të lirë.

Pra, për mua kjo që po na ndodh dëshmon më tepër botën post-faktuale, atë të kaosit të opinionit. /Botuar për herë të parë më 20 qershor 2018, në gazetën "Dita".

Dashuria është një fabrikë që punon pa pushim


Nga: Zygmunt BAUMAN
(pjesë nga intervista në "La Repubblica", 20 nëntor 2012)

Dashuria nuk është një objekt i parapaketuar dhe gati për përdorim. Atë ia kemi besuar kujdesit tonë, ka nevojë për një angazhim të vazhdueshëm, që të rigjenerohet, rikrijohet dhe ringjallet çdo ditë. Dhe dashuria ta kthen këtë vëmendje mrekullisht ... Tregu ka ndërjerë në nevojën tonë të dëshpëruar për dashuri mundësinë për fitime të jashtëzakonshme. Dhe na josh me premtimin se mund të kemi gjithçka pa mundim: kënaqësi pa punë, fitime pa sakrifica, rezultate

pa përpjekje, dije pa proces mësues. Dashuria kërkon kohë dhe energji.

Por, sot të dëgjojmë ata që duam, t'i kushtojmë kohën tonë për t'i ndihmuar në momente të vështira, duke plotësuar nevojat dhe dëshirat e tyre më shumë se tonat, është shndërruar në diçka sipërfaqësore: blerja e dhuratave në një dyqan është më se e mjaftueshme për të kompensuar mungesën e dhembshurisë, miqësisë dhe vëmendjes sonë. Ne mund të blejmë gjithçka, por jo dashurinë. Nuk do ta gjejmë dashurinë në një dyqan. Dashuria është një fabrikë që punon pa pushim, njëzet e katër orë në ditë, shtatë ditë në javë.





EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Envert
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



FShF-ja padit Shefki Kuqin

PRISHTINË, 16 MARS - Ish-futbollisti Shefki Kuqi kishte deklaruar në një emision sportiv se i janë kërkuar para nga Federata Shqiptare e Futbollit për të luajtur për

Kombëtaren e Shqipërisë. Për këtë akuzë, FShF-ja e ka paditur ish-reprezentuesin e Finlandës në Gjykatën Themelore të Prishtinës. “Federata Shqiptare e Futbollit

ka ndërmarrë hapat ligjorë duke paditur për shpifje ish-futbollistin Shefki Kuqi, i cili në një deklaratë publike në televizionin ATV, gjatë emisionit ‘Favoriti i Botërorit’,

ka deklaruar se në fundvitet ’90 i janë kërkuar para për t’u pajisur me pasaportë shqiptare dhe përfaqësuar kombëtaren shqiptare”, thuhet në njoftimin e FShF-së.



Sokoli: Rrahmani kërkoi të luante te Drenica

PRISHTINË, 16 MARS - Trajneri i Malishevës, Bylbyl Sokoli, ka dhënë një intervistë për mediumin e madh italian “SportItalia” gjatë së cilës ka folur për hapat e parë të karrierës së Amir Rrahmanit, i cili po shkëlqen me Napolin dhe tashmë është pjesë e tetë skuadrave më të mira të Ligës së Kampionëve. “Amiri jetonte në kryeqytetin tonë, në Prishtinë, dhe luante në një klub të vogël në kryeqytet. Fillimisht ai u transferua në FC Prishtina, ku u refuzua nga një trajner i ardhur nga Bundesliga. Ai erdhi te ne vetë, duke kërkuar të luajë në KF Drenica, e cila ishte në të njëjtën ligë (Superligën e Kosovës). Ne folëm shkurt dhe vendosëm ta mbajmë për të paktën dy javë. Në seancën e parë stërvitore u vu re se ishte një futbollist me karakter të fortë, por teknikisht me shumë vend për përmirësim. Në stërvitje Rrahmani shquhej për angazhimin në punë, marrëdhëniet e ngushta me

shokët e skuadrës, në lojë ishte i pakompromis dhe shumë inteligjent në zbatimin e urdhrave të dhëna nga trajneri. Nuk vonoi shumë për të kuptuar se ia vlen”, ka thënë Sokoli.

Më tutje ai flet për cilësitë kryesore të kapitenit të Kosovës: “Ai u rrit menjëherë në Kosovë, duke u shquar për fizikun e tij, mbrojtjen e disiplinuar dhe për rrezikshmërinë nga goditjet e dënimit. Shënonte shpesh me kokë. Pas një viti e gjysmë në Superligë, filloi të merrte ftesa nga Superliga. Liga Shqiptare, e cila në atë kohë ishte më cilësore. Më kujtohet një i ri i sjellshëm, i disiplinuar dhe shumë i përpiktë. Ai donte të arrinte gjithçka me zell dhe punë të palodhur. Ai ishte shumë miqësor me shokët e tij dhe shumë ambicioz”.

Trajneri kosovar thotë se te rritja e Rrahmanit kanë ndikuar edhe kushtet e vështira në të cilat ka punuar si dhe lufta dhe regjimi serb mbi Kosovën. “Unë



mendoj se po. Shumë futbollistë në Kosovë janë rritur në kushte të vështira dhe është e kuptueshme që vuajtjet e shumë familjeve për regjimin serb, infrastruktura e shkatërruar, traumat, një kampionat shumë i vështirë për t’u mbajtur dhe izolimi shumë i gjatë i Kosovës nga UEFA dhe FIFA, kanë shërbyer për krijimin e sportistëve me karaktere të

forta, ndër të cilët edhe Rrahmani. Si shumë futbollistë të kësaj gjenerate, edhe Amiri karakterizohet me përkushtimin, qasjen dhe këmbënguljen në arritjen e synimeve të tij si futbollist”, ka theksuar Sokoli.

Për të ardhmen Sokoli e këshillon Rrahmanin të mos largohet nga Napoli. “Duke marrë parasysh formën e

Napolit për momentin, unë do t’i sugjeroja që të qëndrojë aty ku është. Përderisa Napoli të ketë këtë stil, këtë formë, cilësitë e Rrahmanit do të rriten çdo ditë. Duke e njohur, ai nuk do të jetë i kënaqur me sukseset e tij dhe do të jetë gjithmonë në kërkim të ډiçkaje më shumë. Prandaj i uroj vetëm suksese dhe fat në karrierë”, ka përfunduar Sokoli.

Ish-basketbollisti i NBA-së vjen në Kosovë



PRISHTINË, 16 MARS - Ish-basketbollisti i famshëm i NBA-s, Gordan Giricek, do të vijë në Kosovë. Giricek është ambasador i JR NBA, ndërsa do të jetë i pranishëm në ceremoninë e Draft Shortit për JR NBA Kosova, që do të mbahet më 20 mars (e hënë) nga ora 17:30 në Hotel “Four Points by Sheraton Prishtina”. Ai do të vijë në vizitë zyrtare në Kosovë së bashku me Erik Brucker, menaxher i lartë për operacionet e NBA-së dhe do të

kenë takime me drejtuesit e Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK).

Gordan Giricek është basketbollisti i njohur. Për gjashtë vjet ka luajtur në Ligën më të fortë të basketbollit në botë, NBA. Ai e filloi karrierën në Cibona për të vazhduar në CSKA Moskow, ndërsa më 2002 kaloi në NBA te skuadra e Memphis Grizzlies, për të vazhduar më pas në Orlando Magic, Utah Jazz, Philadelphia 76ers, Phoenix Suns, kurse në

fund luajti në Fenerbahçe dhe karrierën e përfundoi aty ku e nisi te Cibona Zagreb. Giricek është tetë herë kampion në Kroaci, një herë kampion në Turqi, ka fituar katër Kupa të Kroacisë dhe një Kupë të Turqisë. Më 20 mars është drafti i JR NBA Kosovës, projekt ky që është në vitin e dytë, ndërsa filloi vitin e kaluar ku 30 shkolla fillore ndahen në dy konferenca apo gjashtë divizione e në fund zhvillohet “Final Four” dhe shpallet kampioni i kësaj gare.

Infantino, president i FIFA-s edhe për katër vjet

KIGALI, 16 MARS - Gianni Infantino mbetet në krye të FIFA-s edhe për katër vjet. 52-vjeçari, i vetmi kandidat, u konfirmua për presidencën në Kongresin e 73-të të FIFA-s që po zhvillohet në Kigali, Ruanda, dhe për këtë arsye do të

qëndrojë në detyrë deri në vitin 2027. “Ne ju premtuam Kupën e Botës më të mirë ndonjëherë dhe e bëmë. Premtuam se do t’i rrisim të ardhurat e FIFA-s, se do ta bënim më transparente, se do ta rifitonim besimin e sponsorëve. I vumë vetes

synimin për të arritur 6.4 miliardë dollarë. Ne kemi arritur në 7,5 dhe nuk mund t’i merrni këto shifra nëse nuk jeni një organizatë solide dhe e fortë, në të cilën të gjithë besojnë. Ajo që ju premtuam ishte ta vazhdonim punën me

ndershmëri, ta mbrojmë futbollin, federatat tona, tifozët tanë nga e gjithë bota. Futboli është simbol i gëzimit, lumturisë dhe paqes. Futboli bashkon botën”, ka deklaruar Infantino në konferencën për shtyp.



Tre shqiptarë në listën e Zvicrës

CYRRI, 16 MARS - Trajneri i Zvicrës, Murat Yakin, e ka publikuar listën e futbollistëve të ftuar për ndeshjet e marsit, ndërsa në mesin e tyre janë edhe tre futbollistë shqiptarë: Granit

Xhaka, Xherdan Shaqiri dhe Andi Zeqiri. Zvicra do të luajë me Bjellorusinë në Serbi më 25 mars, zgjedhje kjo e bërë nga bjellorusët, të cilët nuk kanë të drejtë të luajnë në territorin e tyre pasi janë në

një linjë me Rusinë në luftën kundër Ukrainës. Krahas Bjellorusisë, Zvicra, e cila bën pjesë në një grup me Kosovën, do të luajë edhe me Izraelin në Gjenevë më 28 mars.

Lista e futbollistëve: Kobel, Omlin, Sommer, Akanji, Comert, Elvedi, Lotomba, Rodriguez, Schimid, Widmer, Zesiger, Amdouni, Embolo, Fernandes, Freuler, Okafor, Rider, Shaqiri, Sow, Steffen,



Vargas, Xhaka, Zakaria, Zeqiri.

Napoli shkruan historinë në Ligën e Kampionëve, ëndrrat janë të mëdha

NAPOLI, 16 MARS - Napoli shkruan historinë në Ligën e Kampionëve, për herë të parë kualifikohet në fazën çerekfinale, por askush nuk dëshiron të ndalet këtu. Ky është viti perfekt për të ëndërruar për gjëra të mëdha. Ekipi i Luciano Spallettit zhvilloi një ndeshje fantastike përballë Frankfurtit, fitojnë edhe në "Maradona" me rezultatin e pastër 3-0. Victor Osimhen ishte njeriu i ndeshjes, autor i dy golave. Në limitet e pjesës së parë, Osimhen realizoi një gol shumë të bukur me kokë, ndërsa me fillimin e pjesës së dytë e kishte të lehtë ta dërgonte topin në rrjetë me portën e boshatisur. Për ta kompletuar mbrëmjen mendoi Zielinski që realizoi golin e tretë nga pika e bardhë e penaltisë. Trajneri Spalletti nuk e fsheh



gëzimin për këtë arritje të madhe: "Ky është një rrugëtim i madh, nuk kishim arritur kurrë kaq larg. Është një rezultat i madh që duhet ta shijojmë së bashku me tifozët tanë". Ndërsa sulmuesi në topformë Victor

Osimhen është shprehur: "Është shumë bukur të japësh kontribut në këtë skuadër. Kemi bërë një ndeshje të madhe. Vijojmë të ëndërrojmë pasi jemi një ekip i madh me një trajner të madh mund të shkojë deri në fund".

Bostoni e Philadelphia synojnë kreun në Lindje, ngecin lakersat dhe Warriorsi



HOUSTON, 16 MARS - Bostoni rikthehet të fitorja dhe shpreson ende për kreun e renditjes në Lindje pas fitores me rezultat 104-

102a ndaj Minnesotas. Ndeshje me mjaft rivalitet, ku për miqtë u dalluan Browni me 35 pikë e 10 rebounde si dhe Tatum me 22 pikë e 12 rebounde. Vijon sezoni me luhajtje për lakersat, që u mundën me shifrat 114-110 nga Houstoni. Mungesa e Jamesit dhe Davisit u ndie shumë të lakersat (Reaves 24 pikë), ndërkohë që për Houstonin u dallua Porter imë 27 pikë. Skuadra kampione e Golden States u mund me rezultat 134-126 nga clippersat. Edhe pse Curry realizoi 50 pikë, ato s'mjaftuan për

ta shmangur humbjen. Për clippersat shkëlqeu i zakonshmi Leonard, me 30 pikë. Edhe Philadelphia synon kreun në Lindje, pas fitores me shifrat 118-109 ndaj Clevelandit. Embiid realizoi 36 pikë e 18 rebounde, mbështetur nga Hardeni me 28 pikë e Maxey me 23 pikë. Miami, falë 73 pikëve të trios Butler-Adebayo-Herro, mundi me shifra 138-119 Memphisin, ndërsa Dallasi fitoi me rezultat 137-128 ndaj San Antonios pas kohës shtesë (Wood 28 pikë).

REZULTATET

Cleveland - Philadelphia	109-118
Miami - Memphis	138-119
Chicago - Sacramento	114-117
Houston - Lakers	114-110
Minnesota - Boston	102-104
San Antonio - Dallas	128-137
Clippers - Golden State	134-126

Xavi e dëshiron Gundoganin

Trajneri i Barcelonës, Xavi Hernandez, pritet të angazhohet personalisht për të

bindur Ilkay Gundogan të transferohet në "Camp Nou". 32-vjeçarit i ka skaduar kontrata

me Manchester Cityn dhe ende nuk ka vendosur për të ardhmen e tij, ndaj agjenti i tij

po kërkon mundësi. Gundogan ka luajtur edhe për Nurnbergun dhe Borussia Dortmundin,

ndërsa për Kombëtaren e Gjermanisë ka regjistruar 66 paraqitje.

SHKURT

Yakin: Xhaka është kapiteni ynë, një lider i lindur

Trajneri i kombëtares zvicerane, Murat Yakin, gjatë konferencës për medie thuri lëvdata për Granit Xhakën, pasi u raportua që tifozët kërkonin t'ia largonin shiritin e kapitenit. "Jemi 100 për qind prapa dhe në mbështetje të Xhakës. Graniti është kapiteni ynë. Këtu s'ka asnjë dyshim e as diskutim. Ai është një lider i lindur, është një shembull, të cilin e jep brenda dhe jashtë fushës. Këto janë pikërisht ato që i pres nga një kapiten. Jam shumë i lumtur që e kam Granitin në skuadër", ka deklaruar Yakin.

Ancelotti: Milanin e dua në finale

Carlo Ancelotti me Real Madridin është kualifikuar në çerekfinale të Ligës së Kampionëve, pasi e ka mposhtur në të dyja ndeshjet Liverpoolin me rezultat të përgjithshëm 6-2. Trajneri italian pas këtij suksesi ka thënë se dëshiron që në finale të kësaj gare të takohet me skuadrën e Milanit, të cilën e kishte drejtuar në të kaluarën dhe është i lidhur emocionalisht. "Zhvilluam ndeshjen që dëshironim. Liverpooli është një klub zotërinjsh dhe ky kualifikim merr me shumë vlera. Kë dëshiroj në çerekfinale? Nuk e di, di vetëm të them që Milanin e dua në finale, jo tani", ka thënë Ancelotti.

Klopp: U kualifikua ekipi që e meritoi më shumë

Liverpooli është eliminuar nga Liga e Kampionëve, duke pësuar dy humbje nga Real Madridi. Trajneri Jurgen Klopp e ka pranuar se skuadra spanjolle me meritë është kualifikuar në çerekfinale. "Nëse dëshiron të kalosh turin duhet të bësh një paraqitje speciale. Ne nuk e bëmë. U kualifikua ekipi që e meritoi më shumë", ka thënë Klopp.

Alonso: Ne jemi rivalët e Red Bullit, kemi lënë pas Ferrarin e Mercedesin

Pas vendit të tretë dy javë më parë, në garën hapëse të Botërorit të Formulës 1 në Bahrein, piloti spanjoll i Aston Martinit, Fernando Alonso, shpreson të vijojë me këtë ritëm edhe në pistën e Jeddah. Veterani i Formulës 1 u shpreh se do të jetë Aston Martini skuadra që do ta rivalizojë Red Bullin këtë sezon, por pret konfirmime edhe nga kjo garë e dytë. "Në Bahrein makina shkoi mjaft mirë dhe e shijuam atë podium. Tani jemi në një pistë tjetër, që është ndryshe nga ajo e Bahreinit dhe që duhet të sjellë një makinë të përshtatur në mënyrë tjetër. Ndaj do të jetë kjo garë që do të na tregojë nëse Aston Martin mund të përshtatet mirë me çdo lloj piste. Nëse po, atëherë kjo do të jetë një fitore e madhe për ne", ka thënë Alonso. "Mendoj se vetëm pas garës së tretë në Australi mund të themi se deri ku mund të shkojë kjo makinë këtë sezon. Në atë moment do të kemi zhvilluar tri gara dhe do ta testojmë makinën në tri pista të ndryshme, në tri gara të ndryshme. Ne jemi me Formula 1 këmbë në tokë, por fakti që mund të duelojmë me Red Bullin duke lënë pas Ferrarin e Mercedesin na motivon", ka shtuar Alonso.



NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE
NPL PERPARIMI SH.A 1 - VUSHTRRI
Nr: Protokolit: 313/03
Data: 15.03.23

Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.12.2010, lidhur me nenin 4 dhe nenin 5 të Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017, nenit 8 par. 4, nenit 11, nenit 21 nën par. dhe 2.2 dhe nenit 25 të Rregullores Nr. 55/21 për Marrëdhënien e Punës të N.P.L "Perparimi" Sh. A. në Vushtrri e miratuar me datë 21.12.2021 nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L "Perparimi" Sh. A. e duke u bazuar në vendimin me nr. 311/23 të datës 15.03.2023 të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L "Perparimi" Sh. A me datë 15.03.2023 shpall:

KONKURS PUBLIK

(Për plotësimin e vendit të lirë të punës "Sigurim Fizik")

- I. **Titulli:** Sigurim Fizik - roje
Numri i ekzekutuesve: 1
Orët e punës: 40 orë në javë
Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar gjashtë (6) muaj, nga të cilat tre (3) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.
Përgatitja profesionale: Shkolla e Mesme
Përvoja e punës: Preferohet gjashtë (6) muaj
I raporton: Udhëheqësit të njësisë së Sigurimit Fizik
Koeficienti i pagës: 3.9

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryejë detyrat e punës;
- Përkujdeset mbi sigurimin e objektit dhe pasurisë të organizatës, institucionit publik;
- Në rast të ndonjë rreziku lajmëron menjëherë personat kompetent;
- Sipas nevojës mund të caktohet edhe në lokacion tjetër për sigurim fizik;
- Është i obliguar të përdorë të gjitha mjetet e parapara të mbrojtjes në punë;
- Të jetë i aftë që të përdor mjetet kundër zjarrit;
- Për punën që kryen i përgjigjet udhëheqësit të njësisë së Sigurimit Fizik;
- Kryen dhe punë tjera në bazë të urdhrave nga menaxhmenti i ndërmarrjes.

Kushtet e veçanta

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Shkathësi fizike, preferohet të ketë të përfunduar trajnime nga fusha e sigurisë fizike e preferuar;

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L "Perparimi" Sh. A - Vushtrri;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (Diploma të sillet e noterizuar);
- Ekstraktin e lindjes (Duhet të jetë origjinal);
- Certifikatën nga Gjykata në lidhje me të kaluarën kriminale e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se gjashtë (6) muaj.
- Dëshmitë për përvojën e punës nëse ka;
- Kopjen e letërnjoftimit;

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit.

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin dhe ta dorëzojnë në zyrën e Arkivës të N.P.L "Perparimi" Sh. A në qytetin e Vushtrrisë, rr. "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" nr. 82, (ish objekti i TMK-së afër Gjykatës Themelore Mitrovicë - dega në Vushtrri) çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00.

Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe e-mail adresën. Shpallja është e hapur nga data 15.03.2023 deri me datë 29.03.2023 në ora 16:00.

N.P.L "Perparimi" Sh. A në Vushtrri ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Për informata shtesë mund të kontaktoni në këtë nr.tel. 044 - 157 - 075.

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.



NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE
NPL PERPARIMI SH.A 1 - VUSHTRRI
Nr: Protokolit: 313/25
Data: 15.03.23

Na osnovu članom 8, članom 10 pod st. 2.2, član 15 Zakona br. 03/L-212 o radu objavljen u Službeni list Republike Kosovo, od dt. 01.12.2010, u vezi sa članom 4 i 5 Administrativnog uputstva br. 07/2017 o regulisanje procedura konkursa na javnom sektoru koji je deo Zakona br. 03/L-212 o radu, koji je objavljen u Službenom listu Republike Kosovo od dt. 31.10.2017, član 8 st. 4, član 11, član 21 pod st. i 2.2 i člana 25 Uredbe 55/21 o radnim odnosima N.P.L "Perparimi" Sh. A. u Vučitrnu odobreno 21.12.2021, na osnovu odluke br. 311/23 od 15.03.2023, od glavnog izvršnog direktora, N.P.L "Perparimi" Sh. A 15.03.2023 objavljuje:

JAVNI KONKURS

(Za popunu radnog mesta „Fizičko obezbeđenje“)

- I. **Naslov:** Fizičko obezbeđenje
Broj izvršilaca: 1
Radno vreme: 40 sati nedeljno
Trajanje imenovanja: Na određeno vreme od šest (6) meseci, od čega će tri (3) meseca biti probni rad, sa mogućnošću produženja.
Stručna priprema: Srednja škola
Radno iskustvo: Najmanje šest (6) meseci
Izveštava: Rukovodioci jedinice za fizičko obezbeđenje;
Koeficijent plate: 3.9

Opis radnih obaveza i odgovornosti:

- Biti sposoban da obavlja radne obaveze sa punim radnim vremenom i bez ograničenja;
- Stara se o bezbednosti objekta i imovine organizacije, javne ustanove;
- U slučaju bilo kakve opasnosti, odmah obavestiti nadležna lica;
- Obavezno je koristiti sredstva predviđena sredstva zaštite na radu;
- Umeti da koristi opremu za gašenje požara;
- Po potrebi, moţetetakode je raspoređen na drugu lokaciju radi fizičkog obezbeđenja;
- Za svoj rad odgovoran je rukovodilac jedinice fizičkog obezbeđenja.
- Obavlja i druge poslove po nalogu uprave preduzeća;

Posebni uslovi:

- Da ste državljanin Republike Kosovo;
- Fizičke sposobnosti, poţeljno je imati završenu obuku iz oblasti fizičkog obezbeđenja Favorite;

Uz prijavu je potrebno priloţiti sledeće:

- Obrazac prijave za NPL "Perparimi" Sh. A. ;
- Dokaz o školskoj spremi (diploma se overava);
- Izvod iz rođenja (mora biti originalan);
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Kopija lične karte;
- Sudsko uverenje o krivičnoj prošlosti koje ne sme biti starije od šest (6) meseci.
- Potvrda suda kojom se dokazuje da nije pod istragom i da se donosi u originalnom obliku (ne starije od 6 meseci);

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja.

Zainteresovani kandidati mogu uzeti i predati prijavnii formular u kancelariji Arhiva N.P.L. „Peparimi“ Š. A u gradu Vučitrnu, ul. „Gjergj Kastriot Skenderbeu“ br. 82, (bivša zgrada TMK kod Osnovnog suda u Mitrovici – filijala u Vučitrnu) svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Kandidati koji konkurisu moraju da unesu tačnu adresu, kontakt telefon i e-mail adresu. Oglas je otvoren od 15.03.2023 do 29.03.2023 u 16:00 časova.

N.P.L "Peparimi" Š. A u Vučitrnu nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosovo. Za dodatne informacije možete se obratiti na ovaj broj telefona. 044 - 157 - 075.

Napomena: Prijave dostavljene nakon navedenog roka neće biti prihvaćene, a nepotpune prijave će biti odbijene.


KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 16.01.2023 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, KRM "Uniteti" SH.A vendosi që me datë 17.03.2023 të rishpall:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendit të punës:

Një (1) Punëtor Fizik -Njësia në Skënderaj me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave në automjete – kamion kompaktor dhe traktor;
- Zbrazen e konteinerëve dhe pastrimin e lokacionit rreth tyre nga zona e shërbimit gjerë në deponi;
- Kryen pastrimin, larjen dhe spërkatjen e sipërfaqeve publike, rrugëve dhe shesheve;
- Kryen punët e grumbullimit të mbeturinave në konteiner, kryen punët rreth pastrimit të borës, hedhjes së kripës industriale, heqjen e akullit;
- Është i obliguar të ketë sjellje korrekte ndaj qytetarëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve;
- Është përgjegjës për përdorim të kujdesshëm të konteinerëve gjatë punës, kryen edhe punë tjera të natyrës së ngajshme të cilat i cakton udhëheqësi i tij i drejtëpërdrejtë.

Kualifikimet e kërkuara:

- Diploma e shkollës fillore ose të mesme e preferueshme;
- Të prezantoj leternjoftimin;
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës).

Kushtet e veçanta:

Punëtori gjashtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do ti vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mund të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë.

Konkursi do të jetë i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 17.03.2023 deri më datën 31.03.2023. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.


KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit të datës 16.01.2023 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, KRM "Uniteti" SH.A vendosi që me datë 17.03.2023 të shpall:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendit të punës:

Një (1) Punëtor Fizik -Njësia në Skënderaj me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave në automjete – kamion kompaktor dhe traktor;
- Zbrazen e konteinerëve dhe pastrimin e lokacionit rreth tyre nga zona e shërbimit gjerë në deponi;
- Kryen pastrimin, larjen dhe spërkatjen e sipërfaqeve publike, rrugëve dhe shesheve;
- Kryen punët e grumbullimit të mbeturinave në konteiner, kryen punët rreth pastrimit të borës, hedhjes së kripës industriale, heqjen e akullit;
- Është i obliguar të ketë sjellje korrekte ndaj qytetarëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve;
- Është përgjegjës për përdorim të kujdesshëm të konteinerëve gjatë punës, kryen edhe punë tjera të natyrës së ngajshme të cilat i cakton udhëheqësi i tij i drejtëpërdrejtë.

Kualifikimet e kërkuara:

- Diploma e shkollës fillore ose të mesme e preferueshme;
- Të prezantoj leternjoftimin;
- Çertifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës).

Kushtet e veçanta:

Punëtori gjashtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese, dhe varësisht nga performanca e tij do ti vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës.

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mund të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë.

Konkursi do të jetë i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 17.03.2023 deri më datën 31.03.2023. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Home -Styles" SH.P.K. Adrian Salihu, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810118499 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Home -Styles" D.O.O. Adrian Salihu, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810118499 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Home -Styles" L.L.C. Adrian Salihu, has come to the decision to quit its business: 810118499 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ilir Binaku shpall të pavlefshme certifikatën e lëshuar nga Qendra e Aftësimit Profesional, kursi instalues elektrik me nr. 439/2021

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



PASHTETË PULE

MEKA
HALAL FOOD

gluten
free



100% mish pule



cilësi e garantuar

pa konservues